



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 823/6 Prot.

Tiranë, më 21.04 2026

V E N D I M

Nr. 61 dt. 21.04 2026

**“PËR
MIRATIMIN E FORMATEVE TË PËLQIMIT TË INFORMUAR PËR REALIZIMIN E
KËRKIMIT SHKENCOR, NË UST”**

Mbështetur në nenin 3, 38, 44, 95 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 7, 20, 30, 83 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, nenet 22, 23, 25 të Kodit të Etikës të Universitetit të Sporteve të Tiranës, shkresën e Këshillit të Etikës nr. 761/3 prot., datë 09.04.2026 “Përcjellje e formateve të pëlqimit të informuar dhe publikimi i tyre”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 21.04.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formateve të pëlqimit të informuar për realizimin e kërkimit shkencor, në UST (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim njësisive kryesore të UST-së, Këshillit të Etikës si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Agron KASA

